



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:271751

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05749327

KPPP.nr.2101/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Banka Kombëtare Tregtare Kosovë” SH.A., me seli Prishtinë, rruga “Ukshin Hoti” nr.29, kundër debitorëve 1. Kompania “Europa 2020” SH.P.K., me NUI:810193269, me seli në Prishtinë, fshati Besi, dhe 2. K.H., me numër personal identifikues ..., me adresë në Prishtinë, rruga “Zenel Haradini”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Avdullah Hoti, avokat nga Fushë Kosova, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.428/2023 të datës 11.10.2023, të Përmbartuesit Privat Fadil I. Hoxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorëve 1. Kompania “Europa 2020” SH.P.K., dhe 2. K.H., i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.428/2023 të datës 11.10.2023, të Përmbartuesit Privat Fadil I. Hoxha.
- II. MBETET NË FUQI urdhri përmbartimor P.nr.428/2023 i datës 11.10.2023, i Përmbartuesit Privat Fadil I. Hoxha.

A r s y e t i m

Përmbartuesit Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.428/2023 të datës 11.10.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartimore - Marrëveshja mbi Pengun Nr.10202/21 e datës 24.12.2021, Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut R-20211224-432 i datës 24.12.2021, duke detyruar debitorët që në mënyrë solidare t’ia paguajnë kreditorit shumën prej 24,657.20 €, si dhe shpenzimet e

procedurës përbarimore, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm, në të kundërtën realizimi i përbarimit të bëhet përmes bllokimit të të gjitha llogarive bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë për debitorët deri në realizimin e vlerës së borxhit, nëse debitorët nuk kanë mjete në llogaritë bankare atëherë përbarimi të realizohet me sekuestrimin, ruajtjen dhe shitjen e sendeve të luajtshme/pengu i specifikuar në kontratës e pengut dhe dëftesën e regjistrimit të pengut në posedim të debitorëve, deri në përmbushjen e kredisë së kreditorit.

Debitorët në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë theksuar se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përbarimor në asnjë dispozitë nuk e parasheh klauzolën e përbarueshmërisë, ndërsa sipas marrëveshjes së palëve të njëjtat janë dakorduar se mosmarrëveshjet e tyre do t'i zgjidhin pranë gjykatës kompetente e që nënkupton se kjo procedurë mund të zhvillohet në procedurë kontestimore por jo në procedurë përbarimore. Tutje ka shtuar se dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi nuk i plotësojnë as kushtet nga neni 27 i LPP-së, të njëjtat nuk janë dorëzuar në origjinal apo kopje të vërtetuar si dhe nuk përmbajnë klauzolën e përbarueshmërisë. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorëve, ta anuloj urdhrin përbarimor si dhe të detyroj kreditorin që të paguaj shpenzimet e përpilimit të prapësimin në shumën prej 312.00 €.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka deklaruar se i kundërshton në tërësi të gjitha pretendimet e debitorëve duke theksuar se përbarimi është caktuar në bazë të dokumentit përbarimor marrëveshjes mbi pengun Nr.10202/21 të datës 24.12.2021, e regjistruar në regjistrin zyrtar të MTI-së sipas konfirmimit R-20211224-432 të datës 24.12.2021, e cila sipas ligjit paraqet titull ekzekutiv, ashtu që urdhri përbarimor është plotësisht në harmoni me nenin 43 të LPP-së. Tutje ka shtuar se në kontratën e kredisë dhe marrëveshjen mbi pengun në mënyrë të saktë janë përcaktuar obligimet e debitorit që rrjedhin nga kontrata e kredisë dhe pasojat ligjore në rast të mos përmbushjes së kredisë. Sa i përket pretendimit se dokumentet nuk janë bashkangjitur në origjinal apo kopje të vërtetuara, ky pretendim nuk qëndron pasi që kreditori dokumentet i ka bashkangjitur në kopje të vërtetuara pranë zyrës së noterit, andaj nga pretendimet e debitorëve të paraqitura në prapësim nuk del asnjë argument me të cilin do të goditej urdhri përbarimor. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorëve, ndërsa urdhri përbarimor ta vërtetoj.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të

provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorëve është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbartues dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: “Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.7, përcaktohen dokumentet përmbartuese siç janë: “...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...” dhe sipas nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se dokument përmbartues paraqet: “...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se “Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit”.

Në rastin konkret Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin përmbartues përkatësisht Marrëveshjen mbi Pengun Nr.10202/21 të datës 24.12.2021, e regjistruar në zyrën për regjistrim të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengun R-20211224-432 të datës 24.12.2021, e cila i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.7, nenit 27 të LPP-së dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, për tu paraqitur si dokument përmbartues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit, pasi që Marrëveshja mbi Pengun Nr.10202/21 e datës 24.12.2021, është regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengun R-20211224-432 të datës 24.12.2021, si dhe e njëjta është paraqitur në kopje të vërtetuar.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet

urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorëve ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2101/23, datë 29.05.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.